

## INTERVISTË

FLET BODO WEBER

# Ndërhyrjet politike, pengesë për EUL

Fitim Gashi

SHTATOR, 2014 – Suksesi më i madh i Misionit të EULEX-it është në dogana, polici, por më pak në gjyqësor, ka thënë në një intervistë për “Kohën Ditore” Bodo Weber, analist në Këshillin për Politika të Demokratizimit (Democratization Policy Council). Por ai ka dilema për mënyrën si është bërë transformimi i këtij misioni gjatë kësaj vere. Sipas tij, planifikimi dhe vendim-marrja janë kthyer në një rrëmujë, pasojat e së cilës ai i sheh në një të ardhme të afërt. Kurse sa i përket luftimit të korrupsionit, Weber mendon se bashkë me EULEX-in kanë dështuar edhe institucionet e Kosovës.

Analisti gjerman Weber, njohës i mirë i rrethanave politike në Ballkan, tha se Kosova nuk është më e kërcënuar, si pjesa tjetër e Evropës, nga terrorizmi. Në krahasim me disa vende të Evropës Perëndimore dhe duke pasur parasysh papunësinë e lartë të të rinjve dhe përvojën e luftës e të shoqërisë kosovare, sipas tij, problemi është relativisht i vogël.

Weber ka folur edhe për pasojat e ngërçit institucional, për situatën e brishtë në veri të Kosovës, si dhe për Gjykatën Speciale për krimet e luftës.

## Dështimet e EULEX-it

KD: Keni botuar disa punime dhe analiza rreth Kosovës në të cilat shpesh trajtoni edhe funksionimin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit. Pas gjashtë vjetësh të EULEX-it në Kosovë, si e vlerësoni punën e këtij misioni?

Weber: Është shumë e vështirë të përmbledhet puna e këtij misioni në disa fjali. Për një

**“Askush brenda spektrit politik nuk është marrë seriozisht me luftën kundër korrupsionit. Por, duke gjykuar nga burimet, ka pasur edhe lloje të ndërhyrjeve nga Brukseli në EULEX, gjë që ka penguar aktivitetin kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”, ka thënë Bodo Weber**

gjykim të drejtë do të duhej të peshonim mandatin dhe punën e EULEX-it duke marrë parasysh kushtet politike në të cilat ka punuar – pra në kushtet e një dështimi për ta zgjidhur plotësisht konfliktin Kosovë-Serbi përmes krijimit të një shteti plotësisht sovran të Kosovës, me integrimin e serbëve qysh në vitin 2008 – pastaj ndryshimet në strukturën organizative të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së (krijimin e MSA-së) – dhe sfidat e tjera në terren që kërkojnë vendosmëri për të kontribuar në forcimin e qëndrueshëm të sundimit të ligjit në Kosovë. EULEX-i vetëm ka filluar të lëvizë brenda kushteve kornizë dhe mandatit origjinal i paraparë me ristrukturimin e vitit 2012, kur paralelisht filloi dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Puna e tij nisi në kohën kur përballë tashmë nga një presion që vinte nga elitat politike në Kosovë, i pranuar gjerësisht dhe përforcuar nga shtetet kryesore anëtare të BE-së.

KD: A ka arritur EULEX-i të përmbushë mandatin e tij, duke marrë parasysh edhe pritjet e mëdha që kanë qenë?

Weber: Unë them se, duke marrë parasysh sfondin e kufizimeve strukturore, të cilat i përmenda më lart, të arriturat nuk janë aq të pakta, por sigurisht për shkak të mandatit që ka pasur EULEX-i, pritjet kanë qenë të larta, veçanërisht nga qytetarët e Kosovës që duan siguri dhe sundim të rendit e ligjit.

KD: Në cilat fusha i shihni arritjet më të mëdha të këtij misioni?

Weber: Me siguri suksesi më i madh është në dogana, pastaj në polici, por më pak në gjyqësor. Por ka edhe një mori të arritjeve indirekte, sidomos në vendosjen e përgjithshëm të një rregulli institucional dhe legjislativ sidomos gjatë 3 vjetëve të fundit. Me siguri se nuk do të kishte ndodhur transformimi në Kosovë në formën si është tani, pa përvojën dhe ndikimin e EULEX-it, pra gjykatësve dhe prokurorëve, gjë që ia jep edhe BE-së një pasqyrë të pastër të gjendjes së gjyqësorit në Kosovë.

KD: Megjithatë, EULEX-i kishte premtuar rezultate të mëdha në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, por deri më tani nuk janë përmbushur pritjet. A shihni një dështim të EULEX-it në adresimin e këtyre çështjeve?

Weber: Korrupsioni është një problem sistematik në Kosovë, i cili rrjedh nga shumë faktorë – e kaluara socialiste dhe shoqërizimi, rrethanat e luftës, duke përfshirë disa kërcënime shumë të pakëndshme që janë në kundërshtim me rrethanat e luftës kombëtare dhe nacionaliste, një shoqëri e vogël, post-tradicionale në të cilën është veçanërisht sfiduese për të ndarë privaten nga publikja, plus sistemi ekzistues paralel ekonomik dhe institucional serb në veri. Kjo çështje nuk mund të zgjidhet vetëm nga EULEX-i, sidomos duke pasur parasysh rrethanat e përgjithshme të punës së këtij misioni. Megjithatë ka pasur progres prej vitit 2012.

## Ndërhyrjet nga Brukseli

KD: Por janë vetë zyrtarët e EULEX-it që në deklaratat publike kanë premtuar shpesh se do t'i kapin “peshqit e mëdhenj”, si sinonim i zyrtarëve të lartë të dyshuar se janë përfshirë në aktivitete korruptuese. Përveç disa rasteve të profilit të lartë që ende nuk kanë përfunduar – ky premtim nuk u materializua kurrë. A është kjo për shkak se EULEX-it nuk i lejohet të merret me zyrtarë të lartë për shkak të pasojave politike që mund të jenë, apo është diçka tjetër?

Weber: Është një kombinim i faktorëve, duke filluar nga problemi ende prezent për të mbrojtur burimet dhe dëshmitarët në një shoqëri ku secili e njeh secilin, dhe po ashtu askush brenda spektrit politik nuk është marrë seriozisht me luftën kundër korrupsionit. Por duke gjykuar nga burimet, ka pasur edhe llo-

Kosova ende nuk është gati t'i marrë kompetencat që ka momentalisht EULEX-i, thotë analisti gjerman Bodo Weber





# EX-in në luftën kundër korrupsionit

je të ndërhyrjeve nga Brukseli në EULEX, gjë që ka penguar aktivitetin e tij kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

**KD:** A janë të gatshme institucionet e Kosovës për t'i marrë kompetencat nga EULEX-it, veçmas t'i trajtojë rastet e rënda të korrupsionit dhe krimit të organizuar?

**Weber:** Me gjithë progresin e arritur në Policinë e Kosovës dhe në gjyqësor, në mënyrë të qartë them se jo, sidomos duke pasur parasysh mënyrën shumë problematike të "transicionit" të EULEX-it, i cili ndodhi në pranverë të këtij viti.

**KD:** Si e shihni këtë transicion që ndodhi në mandatin e EULEX-it?

**Weber:** Planifikimi dhe vendimmarrja e mandatit, për fat të keq, janë kthyer në një rrëmujë. Shumë nga ndryshimet ligjore janë mashtruese dhe kam frikë se pasojat negative do t'i shohim në një të ardhme të afërt. Vështirë për të parashikuar efektet e performancës së EULEX-it në dy vjetët e ardhshëm, por kam frikë që kemi dëmtuar një pjesë të madhe të arritjeve të EULEX-it me këto vendime të formës së prerë.


**KD:** Në mandatin e EULEX-it është edhe trajtimi i krimeve të luftës në Kosovë. Si i vlerësoni rezultatet e punës së EULEX-it në këtë fushë?

**Weber:** Puna e EULEX-it në këtë fushë mund të dëmtojë në themel narracionin e shtetit të Kosovës – gjë që është edhe e dhimbshme, por e nevojshme për një shoqëri demokratike dhe prosperuese të Kosovës në të ardhmen. Arritjet gjyqësore janë më pak të ndritshme, gjë që u pasqyrua së fundi me vendimin për themelimin e Gjykatës Speciale. Kjo natyrisht u bë për shkak të nevojës që të ketë dëshmitarë, madje të mbrojtur, që të dëshmojnë jashtë Kosovës për të siguruar një proces të suksesshëm gjatë trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës.

## Sfidat në Veri

**KD:** Sfidë për EULEX-i ka qenë edhe pjesa veriore e Kosovës e dominuar nga serbët. Si e shihni situatën atje, dhe mangësitë më të mëdha të politikës së BE-së dhe funksionalitetit të EULEX-it në Veri?

**Weber:** Veriu është futur disi në një zonë të errët që nga nisja e procesit të dialogut, i cili në vitin 2014 ka përfunduar pak a shumë në një situatë të ngrirë. Problemi kryesor që pengon punën efektive të EULEX-it janë strukturat paralele serbe, të sponsorizuara nga shteti i Serbisë. Bashkimi Evropian, duke përfshirë edhe dialogun e nisur mes dy vendeve, ende nuk ka dalë me një zgjidhje se si të thyejë këtë sistem paralel. Kjo nënkupton arrestimin e disa figurave kryesore të krimit të organizuar dhe në këtë mënyrë duke detyruar të gjithë të fillojnë



EULEX-i vetëm ka filluar të lëvizë brenda kushteve kornizë dhe mandatit origjinal i paraparë me ristrukturimin e vitit 2012, kur paralelisht filloi dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Puna e tij nisi në kohën kur përballëj tashmë nga një presion që vinte nga elitat politike në Kosovë, i pranuar gjerësisht dhe përforcuar nga shtetet kryesore anëtare të BE-së

të respektojnë ligjin, përmes integritetit të policisë, qartësimin e së ardhmes së gjyqësorit, sidomos personelit, i cili pritet të vendoset në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Por çështje apo dilemë e hapur është se kush do të ndërmarrë një hap të tillë. EULEX-i është shumë i dobët, KFOR-i rezistues, kurse ndërmarrja e një aksioni tjetër me njësi speciale tek serbët në veri është politikisht gjë e ndërlikuar.

**KD:** A mendoni se Kosova është e kërcënuar nga terrorizmi dhe radikalizmi fetar, dhe a shihni ndonjë rol tek EULEX-i në luftimin e këtyre kërcënimeve globale?

**Weber:** Unë do të thosha se Kosova nuk është më e kërcënuar se pjesa tjetër e Evropës. Në krahasim me disa vende të Evropës Perëndimore dhe duke pasur parasysh papunësinë e lartë të të rinjve, përvojën e luftës e të shoqërisë kosovare, problemi është relativisht i vogël.

**KD:** A është vështirësuar dhe ndikuar puna e EULEX-it për shkak të situatës aktuale politike në Kosovë?

**Weber:** Jo vetëm EULEX-i, por përgjithësisht gjyqësori dhe sundimi i ligjit në Kosovë janë të ndikuar. Ky lloj i presionit politik nga elitat politike duke instrumentalizuar vendimet, Kushtetutën dhe Gjykatën Kushtetuese, për fat të keq, edhe një herë, nuk flet për pjekurinë e klasës politike në Kosovë. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të Perëndimit për arritjen e sovranitetit të plotë dhe të qëndrueshëm, forcimin e shtetit demokratik e multietnik të Kosovës gjatë dy vjetëve të fundit, mund të ketë rrezik për armiqësimin e aleatëve tuaj perëndimorë për shkak të interesave personale dhe grupore, të cilat shpesh janë vënë përpara interesave të shtetit.

© KOHA Ditore